

## **Shtyhet thirrja për bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Nysës, Poloni në kuadër të Programit Erasmus +**

Në kuadër të Programit Erasmus + është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Nysës, Poloni për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

<http://www.pwsz.nysa.pl/index.php?p=25>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;

### **Kohëzgjatja e mobilitetit:**

- Bachelor (5 muaj);

### **Fushat e studimit:**

- Administrim Biznesi;
- Gjuhë e Huaj;

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruar nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Nysës, Poloni, klikoni në adresën:

<http://www.pwsz.nysa.pl/index.php?p=25,223,0,0,38,0>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 Euro në muaj për studentët)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1);
- \*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Nysës, Poloni, lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti ‘Learning Agreement’ tek seksioni ‘Commitment’ firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatorin Institucional i Erasmus +.*

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing.docx](http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing.docx)

\*Studentët duhet të kryejnë gjithashtu edhe aplikimin online në linkun e mëposhtëm:

[https://erasmus.pwsz.nysa.pl/?page\\_id=27](https://erasmus.pwsz.nysa.pl/?page_id=27)

Afati për aplikim: **18 Nëntor 2019**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!